



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 1572/1 Prot

Tiranë, më 07.11.2019

V E N D I M

Nr.120, datë 07.11.2019

“Mbi përfundimin e verifikimit të kryer në institucionin e qeverisjes vendore Bashkia Himarë të filluar me urdhrin nr. 65, datë 12.09.2019, të Komisionerit”, në lidhje me evidentimin e rasteve të emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil, si dhe zbatimin e standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, në përputhje me parimet e ligjit për nëpunësin civil në këtë bashki.

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit në lidhje me verifikimin e kryer në njësinë e vetëqeverisjes vendore Bashkia Himarë,

VËREJ SE,

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim mbikëqyrjen e zbatimit të ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në lidhje me emërimet në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, si dhe zbatimin e standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, si pjesë e rëndësishme e strukturës organizative të institucionit, me urdhrin nr. 65, datë 12.9.2019, “Për fillimin e procesit të inspektimit në lidhje me rastet e emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil në njësitë e vetëqeverisjes vendore, si edhe verifikimi i zbatimit të standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, si pjesë e rëndësishme e strukturës organizative të institucionit në përputhje me parimet e ligjit për nëpunësin civil”, ka nisur kryesisht procesin e verifikimit në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore (61 bashkitë e vendit), ku përfshihet edhe Bashkia Himarë.

Verifikimi u realizua nëpërmjet vizitës në subjekt nga grupi i inspektimit, i autorizuar nga Komisioneri për këtë qëllim. Nga aktet e administruara gjatë inspektimit në subjekt, ka rezultuar se, Bashkia Himarë, është e organizuar dhe funksionon në bazë të strukturës

miratuar me Vendimin nr. 203, datë 23.11.2018, të Këshillit Bashkiak Himarë, “Për miratimin e numrit maksimal të punonjësve të Bashkisë Himarë për vitin 2019”.

Sipas strukturës aktuale, Bashkia Himarë së bashku me njësitë administrative në përbërje të saj, ka gjithsej **38** pozicione pune të vlerësuara si pjesë e shërbimit civil, të cilat sipas kategorive të shërbimit civil klasifikohen: **1** pozicion i kategorisë së lartë drejtuese **8** pozicione të kategorisë së mesme drejtuese, **8** pozicione të kategorisë së ulët drejtuese dhe **21** pozicione të kategorisë ekzekutive.

- Gjatë procesit të verifikimit në subjekt, u konstatua se **27** pozicione pune të shërbimit civil janë plotësuar nëpërmjet procedurave të konkurrimit të përcaktuara nga ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij; **7** pozicione të shërbimit civil, rezultojnë se aktualisht janë plotësuar me punonjës të punësuar me akt emërimi apo kontrata të përkohshme, dhe jospas një procedure konkurrimi të hapur, e cila është e vetmja mënyrë për të plotësuar pozicionet e punës të kategorisë ekzekutive, apo nëpërmjet lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, për pozicionet e nivelit drejtues; ndërsa **4** pozicione të shërbimit civil rezultuan vende vakante.

7 pozicione “Punonjës Arkive”, “Punonjës i Arshivës dhe Protokollit”, “Punonjës i Financës”, “Punonjës Arkitekt-Urbanist”, “Punonjës i Topografisë”, “Teknik Pyjesh” dhe “Specialist i Shërbimit Veterinar”, rezultojnë me kontratë por njësi përgjegjëse nuk e ka përcaktuar në mënyrë të qartë nëse janë apo jo pozicione të shërbimit civil apo punonjës administrativë.

Për këto pozicione njësi përgjegjëse të saktësojë emërtesat e pozicioneve të punës, të përcaktojë qartë detyrat teknike dhe përgjegjësitë që realizojnë secili pozicion pune dhe për rastet e vlerësuara në kategorinë e nëpunësit civil, të hartohen formularët e përshkrimit të punës dhe të zbatohen kërkesat ligjore për plotësimin e tyre.

Njësi përgjegjëse të përcaktojë në mënyrë të qartë pozicionet e shërbimit civil, duke i ndarë nga pozicionet që do të kryejnë funksione politike dhe nga pozicionet që nuk ushtrojnë funksion publik (*punonjësit administrativë*), dhe t’i përshtasë detyrat, funksionet dhe emërtesat e pozicioneve të shërbimit civil, në përputhje me kërkesat e nenit 19, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar; Vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar, si dhe me ligjet që rregullojnë çdo sektor të veprimtarisë së bashkisë.

Konkretisht, rastet e emërimeve në kundërshtim me ligjin evidentohen si më poshtë, ku specifikohet pozicioni i punës dhe punonjësi që kryen aktualisht detyrën, si edhe akti i emërimit i nxjerrë nga titullari i institucionit:

1. *****; “Specialist jurist i gjyqësorit”, emëruar me aktin nr. 146, dt.1.9.2015.

2. *****, “*Specialist i financës*”, në Drejtorinë e Financë-Buxhetit, emëruar me aktin nr. 34, dt. 5.3.2018.
3. *****, “*Specialist i shërbimit veterinar*”, në Drejtorinë Pyje-Kullota, (Lukovë), pika 5 e aktit nr. 153, dt. 1.9.2015.
4. *****, “*Kontabilist i shpenzimeve dhe të ardhurave*”, në Drejtorinë e Financë-Buxhetit, emëruar me aktin nr. 62, dt. 29.02.2016.
5. *****, “*Drejtor në Drejtorinë e Mbrojtjes dhe Menaxhimit të Tokës*” emëruar me aktin nr. 28, dt. 28.2.2017.
6. *****, në pozicionin “*Specialist topograf*”, në Drejtorinë e Mbrojtjes dhe Menaxhimit të Tokës, emëruar me aktin nr. 57, dt. 29.2.2016.
7. *****, në pozicionin “*Përgjegjës Taksa Familjare*”, emëruar me aktin nr.60, dt 29.2.2016.

Komisioneri konstaton se, aktet e emërimit të evidentuara më sipër, kanë dalë në kundërshtim me ligjin, pasi, për çdo marrëdhënie të re pune, që lidhet pas fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, në bazë të nenit 22, 23, 25 dhe 26 të tij, duhet të respektohen detyrimisht kërkesat e një procedure të rregullt konkurrimi. Çdo emërim që bëhet në kundërshtim me këtë rregull, është absolutisht i pavlefshëm.

Vërejmë se, duke vepruar në këtë mënyrë, titullari i institucionit, ka vepruar në kundërshtim me procedurën e nxjerrjes së aktit, referuar parashikimeve të legjislacionit në fuqi, ç’ka në vështrim të nenit 108, pikat i) dhe ii) të shkronjës “a” dhe shkronjës “ç”, të ligjit nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative i RSH*”, i bën aktet absolutisht të pavlefshëm.

Për më tepër, ndalimi i emërimit në kundërshtim me procedurën, është theksuar shprehimisht në pikën 4, të nenit 23, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, për të mos lejuar subjektivitet apo keqinterpretime në implementimin e kësaj dispozite në praktikë.

Në vijim të këtij arsyetimi, në bazë të nenit 110, pika 1, të ligjit nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative i RSH*”, veprimi administrativ absolutisht i pavlefshëm nuk sjell asnjë pasojë juridike, pavarësisht faktit nëse është konstatuar apo jo si i tillë.

Nisur nga detyrimi i parashikuar nga neni 111, i ligjit në fjalë, vetë organi publik, në këtë rast Kryetari i Bashkisë Himarë, duhet të konstatojë në këto veprime administrative, ekzistencën e rasteve të parashikuara në nenin 108, të ligjit si më lart, dhe të konstatojë menjëherë pavlefshmërinë absolute të këtyre akteve dhe të rregullojë pasojat duke ndërprerë marrëdhënien e punës të lidhur në kundërshtim me procedurat ligjore dhe më tej,

duke i shpallur si të lira këto pozicione, për t'u plotësuar në përputhje me ligjin për nëpunësin civil.

Pozicionet në fjalë, duhet të plotësohen me anën e procedurave të konkurrimit të hapur, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe akteve nënligjore dalë për zbatim të tij, apo nëpërmjet procedurave të lëvizjes paralele dhe të ngritjes në detyrë.

Njësia përgjegjëse, gjatë zhvillimit të procedurave të konkurrimit, duhet të kujdeset të përmbushë rregullat e përcaktuara në kreun IV “Pranimi në shërbim civil”, të ligjitnr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, vendimin nr. 242, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese” dhe vendimin nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, si dhe udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike, “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, referuar Seksionit III, “Procedura hetimore”, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A:

1. Të kërkoj nga Kryetari i Bashkisë Himarë, me synim rregullimin e situatës së ligjshmërisë së administrimit të shërbimit civil, të konstatojë menjëherë, si akte administrative absolutisht të pavlefshëm, Zrastet e emërimit të punonjësve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil dhe të rregullojë pasojat duke i shpallur të lira këto pozicione, me qëllim që të plotësohen në përputhje me ligjin.

- ***** , “Specialist jurist i gjyqësorit”, emëruar me aktin nr. 146, dt.1.9.2015.
- ***** , “Specialist i financës”, në Drejtorinë e Financë-Buxhetit, emëruar me aktin nr. 34, dt. 5.3.2018
- ***** , “Specialist i shërbimit veterinar”, në Drejtorinë Pyje-Kullota, (Lukovë), pika 5 e aktit nr. 153, dt. 1.9.2015.

- ***** , “*Kontabilist i shpenzimeve dhe të ardhurave*”, në Drejtorinë e Financë-Buxhetit, emëruar me aktin nr. 62, dt. 29.02.2016
 - ***** , “*Drejtor në Drejtorinë e Mbrojtjes dhe Menaxhimit të Tokës*” emëruar me aktin nr. 28, dt. 28.2.2017.
 - ***** , në pozicionin “*Specialist topograf*”, në Drejtorinë e Mbrojtjes dhe Menaxhimit të Tokës, emëruar me aktin nr. 57, dt. 29.2.2016.
 - ***** , në pozicionin “*Përgjegjës Taksa Familjare*”, emëruar me aktin nr.60, dt 29.2.2016.
2. Për pozicionet e punës “*Punonjë Arkive*”, “*Punonjës i Arshivës dhe Protokollit*”, “*Punonjës i Financës*”, “*Punonjës Arkitekt -Urbanist*”, “*Punonjës Topograf*” dhe “*Teknik Pyjesh*”, dhe “*Specialist i shërbimit veterinar*”, njësia përgjegjëse të saktësojë emërtesat e pozicioneve të punës, të përcaktojë qartë detyrat teknike dhe përgjegjësitë që realizon secili pozicion pune dhe për rastet e vlerësuara në kategorinë e nëpunësit civil, të hartohen formularët e përshkrimit të punës dhe të zbatohen kërkesat ligjore për plotësimin e tyre.
 3. Të vijojë realizimi i procedurave të konkurrimit për të gjitha vendet vakante të shërbimit civil në kuptim të ligjit, ku përfshihen pozicionet e punës që janë efektivisht të lira si dhe pozicionet e plotësuara në kundërshtim me ligjin, në përputhje me nevojat në strukturën që është në fuqi në momentin e zbatimit të detyrave të vendimittë Komisionerit.
 4. Njësia përgjegjëse të përgatitë dhe të miratojë planin e nevojave për rekrutimin në shërbimin civil për vitin e ardhshëm, për të gjitha pozicionet e mbetura vakant deri në shkurt të vitit 2020, duke respektuar procedurat dhe afatet e përcaktuara në vendimin nr. 108, datë 26.2.2014 të Këshillit të Ministrave, “*Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil*”.
 5. Të përmyllet procesi i mbikëqyrjes, i cili është materializuar me vendimin nr. 94, datë 27.11.2018, të Komisionerit dhe të vijojë rregullimi i situatës ligjore në këtë subjekt sipas detyrave të lëna në këtë vendim.
 6. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **3 (tre) muaj** nga marrja dijëni për këtë vendim. Institucioni i inspektuar dhe njësia përgjegjëse, duhet të zbatojnë këtë vendim, duke u bazuar në orientimet e dhëna në pjesën arsyetuese të tij.

Me kalimin e këtij afati, subjekti i mbikëqyrur, njësia e vetëqeverisjes vendore Bashkia Himarë, duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.

7. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.
8. Për këtë vendim të njoftohet Kryetari i Bashkisë Himarë, Ministria e Brendshme dhe Prefektura e Qarkut Vlorë. Njësia Përgjegjëse e Bashkisë Himarë duhet të njoftojë çdo punonjës që është i emëruar në kundërshtim me ligjin dhe që është i evidentuar në këtë vendim për detyrat e lëna në dispozitivin e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha